

VENDIM
Nr.1237, datë 16.12.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË
MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, e 35 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 23 të kreut III të vendimit nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 23/1, me këtë përmbajtje:

“23/1. Përfitimi i ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në pikat 18, 19, 20, 21 e 22 të këtij vendimi, paguhet nga shërbimet bankare, që funksionojnë pranë njësisë së qeverisjes vendore, ku ka vendbanimin përfituesi, ose nga shërbimi postar për njësitë e qeverisjes vendore, ku nuk ka një të tillë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha